



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Novobërdës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Novobërdës ((KNB)), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Novobërdës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Regjistrimi jo i saktë i pasurive kapitale në regjistrin kontabël dhe prezantimi jo i saktë i pasurive kapitale në PFV, mosregjistrimi dhe aplikim i pasaktë i pasurisë ka rezultuar me nënvlerësim të pasurive në vlerë 14,861€ dhe në anën tjetër me mbivlerësim të pasurisë për 3,654€ si rezultat të regjistrimit të pjesshëm të pasurive dhe aplikimit të zhvlerësimit;
- B2 Parregullsia në raportimin e detyrimeve kontingjente në pasqyrat vjetore financiare (PVF);
- B3 Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike adukuate në vlerë prej 80,899€, si rezultat i ekzekutimit të pagesave bazuar në vendime gjyqësore/përmbartimore.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Novobërdës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B4 Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë;

B5 Vonesat në pagesën e faturave;

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Novobërdës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Novobërdës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Novobërdës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Novobërdës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Novobërdës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit janë identifikuar fusha të ndryshme që kërkojnë përmirësim në menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Çështjet me ndikim më të madh në opinionin financiar përfshijnë: klasifikimin jo të saktë të shpenzimeve, paraqitjen e pasaktë të detyrimeve kontingjente dhe të pasurive jofinanciare.

Në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe në investimet kapitale, janë vërejtur vonesa në pagesat e faturave.

Në fushën e pagave, janë identifikuar mungesë të evidencës së vijueshmërisë në punë dhe zyrtarë të angazhuar si ushtrues detyre përtej afateve të lejuara ligjorisht.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Regjistrimi jo i saktë i pasurive kapitale në regjistrin kontabël

Gjetja

Sipas nenit 11 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcaktohet se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim", "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi".

Ndërsa, sipas nenit 6 parashihet që çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Gjatë auditimit të pasurive jo-financiare, janë identifikuar parregullsi dhe pasaktësi në regjistrimin e pasurive kapitale në regjistrin kontabël të Komunës, konkretisht:

-Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrat kontabël pagesën në vlerë

14,000€ që ka të bëjë me revitalizimin e objektit për Qendrën e angazhimit të komunitetit në bazë të marrëveshjes me OJQ “Qendra e përfshirjes së grave”. Investimet kanë të bëjnë me renovimin e objektit e cila është pronë e Komunës dhe është dashur të regjistrohen në regjistrin kontabël të Komunës. Kjo kishte ndikuar që pasuria të nënvlerësohet për 14,000€;

-Projekti “Asfaltimi i rrugëve në Bolevc - Jasenovik”, me vlerë të kontratës prej 47,374€ ishte regjistruar pjesërisht si investim në vijim në vlerë prej 37,374€, ndërsa 10,000€ ishin regjistruar si pasuri në përdorim, mbi të cilën ishte aplikuar një zhvlerësim në vlerë prej 1,042€. Sipas raportit të pranimit teknik, projekti ka përfunduar me datë 30.11.2023, dhe i gjithë investimi është dashur të klasifikohet si pasuri në përdorim nga kjo datë. Megjithatë, për shkak të regjistrimit të pjesshëm dhe aplikimit të zhvlerësimit vetëm mbi një pjesë të pasurisë, regjistri kontabël nuk pasqyronte gjendjen reale të pasurisë, duke rezultuar në një mbivlerësim neto prej 3,654€; dhe

-Për kontratën “Hartimi i projekteve kapitale për nevojat e Kuvendit Komunal Novobërdë”, Komuna kishte realizuar dy pagesa në vlerë totale prej 8,855€, për hartimin e projekteve kryesore për shtatë (7) projekte kapitale. Këto pagesa janë regjistruar në regjistrin kontabël si pasuri në përdorim, konkretisht: pagesa prej 4,855€ me kodin 31250 - kanalizimi dhe pagesa prej 4,000€ me kodin 31690 - pajisje të tjera, Regjistrimi i këtyre shpenzimeve si pasuri në përdorim është i pasaktë, pasi ato kanë të bëjnë me projektimin e projekteve kapitale të cilat ende nuk kanë përfunduar dhe si të tilla duhej të regjistroheshin si investime në vijim, secila e ndarë sipas projektit kapital për të cilin është hartuar. Regjistri i pasurisë është nënvlerësuar për 861€ për shkak të aplikimit të zhvlerësimit

Parregullsitë e evidentuara janë rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit dhe klasifikimit të pasurive.

Ndikimi

Mangësitë e lartë cekura ndikojnë në mbivlerësimin / nënvlerësimin e gjendjes së pasurisë në pasqyrat financiare vjetore duke mos prezantuar gjendjen e drejtë dhe të saktë të tyre.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që të ndërmerren veprime për përmirësimin e menaxhimit të pasurisë, duke garantuar që regjistrimi dhe klasifikimi i të gjitha pasurive të bëhet në përputhje me gjendjen reale dhe kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Parregullsi në raportimin e detyrimeve kontingjente në pasqyrat vjetore financiare

Gjetja

Sipas nenit 18 të Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Gjatë auditimit të detyrimeve kontingjente, kemi vërejtur se vlera e raportuar në PVF ishte nënvlerësuar në vlerë prej 59,697€, për shkak të rasteve si në vijim:

-Një (1) rast, në vlerë prej 1,624€, ishin prezantuar në pasqyrat vjetore financiare si detyrime kontingjente, mirëpo zyrtarët komunalë nuk na kanë

ofruar dëshmi që kjo nënkupton që nuk posedonin dosjet përkatëse të lëndëve, Kjo ka ndodhur gjatë auditimit të vitit 2025 gjersa rastet në vijim janë të përsëritura nga auditimi i vitit të kaluar.

-Një (1) rast, në vlerë prej 818€, ishte përmbyllur përmes një urdhri përmbarimor, por megjithatë ishte prezantuar gabimisht si padi ende aktive;

-Një (1) padi, në vlerë prej 2,200€, ishte regjistruar dy herë në pasqyrat financiare, duke shkaktuar mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për të njëjtën shumë; dhe

-Dy (2) padi, me vlerë reale prej 5,300€, ishin prezantuar gabimisht si padi në vlerë prej 60,355€. Ky gabim kishte ndodhur për shkak të një lëshimi teknik nga ZKF, i cili gjatë bartjes së të dhënave nga regjistri i zyrës ligjore kishte gabuar në përzgjedhjen e rreshtit. Megjithatë, vlera totale e detyrimeve kontingjente nuk ishte ndikuar.

Mungesa e kontrolleve të brendshme dhe e koordinimit ndërmjet Zyrës Ligjore dhe Zyrës për Financa, si dhe lëshimet në procesin e ruajtjes dhe menaxhimit të dokumentacionit ligjor, kanë ndikuar në raportim jo të saktë të detyrimeve kontingjente

Ndikimi

Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve, njëherësh ndikon në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të sigurojë bashkëpunim më të mirë ndërmjet Zyrës Ligjore dhe Zyrës për Financa për të siguruar që të gjitha detyrimet kontingjente të raportohen me saktësi dhe të jenë të mbështetura me dokumentacionin përkatës. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime për të siguruar trashëgiminë e plotë të lëndëve juridike gjatë ndërrimit të stafit përgjegjës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja

Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga “Rezerva” me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore, përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël.

Po ashtu, plani kontabël i Thesarit përcakton kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që organizatat buxhetore duhet të aplikojnë. Me rastin e ekzekutimit të pagesave nga thesari për obligimet e kontrates kolektive, nga nëntë (9) pagesa kemi vërejtur keqklasifikime të

shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 80,899€. Nga kjo vlerë, nga mostrat e testuara thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor të gjykatës për paga jubilarë dhe shujta për arsimtarë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 36,825€, nga kategoria subvencione dhe transfere 4,074€ dhe nga kategoria e investimeve kapitale 40,000€.

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe realizimin e pagesave nga kategoritë adekuate

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B4 - Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë

Gjetja	Sipas nenit 17 pika 1 e Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik përcaktohet se “Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë”, dhe pika 3 “Kur nuk është e mundur për arsye teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidentues”. Nuk janë siguruar evidencat për vijueshmërinë në punë për të gjithë zyrtarëve komunalë. Kjo ka ndodhur si rezultat i moszbatimit të kërkesave të rregullores për mbajtjen e regjistrit të vijueshmërisë, si rezultat i mungesës së mbikëqyrjes dhe përgjegjshmërisë institucionale.
Ndikimi	Mosmbajtja e evidencave për vijueshmërinë në punë rrit rrezikun për pagesa të pabazuara, krijon paqartësi në raport me angazhimin real të zyrtarëve dhe cenon integritetin e procesit të menaxhimit të pagave.
Rekomandimi B4	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të siguruar që në të drejtoritë komunale të mbahen evidenca të vijueshmërisë në punë, në përputhje me kërkesat e rregullores në fuqi. Po ashtu, duhet të forcohet kontrolli dhe përgjegjësia menaxheriale për zbatimin e kësaj kërkesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Vonesat në pagesën e faturave

Gjetja	Sipas nenit 39 të LMFPP-së, përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Gjatë testimit të mostrave, janë evidentuar dy (2) raste me vlerë të përgjithshme prej 101,365€, në të cilat pagesat nuk janë kryer brenda afatit të përcaktuar me ligj. Konkretisht, vonesat ishin 26 dhe 61 ditë nga data kur pagesat është dashur të kryhen. Vonesat në pagesa kanë ndodhur si rezultat i mungesës së fondeve për kontratat e lidhura dhe vonesave në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm.
Ndikimi	Vonesat në pagesën e faturave vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, si dhe mund të shkaktojnë kosto shtesë në buxhetin e Komunës në formë të kamatave dhe procedurave përmbarimore.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të ndërmarrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm mbi ekzekutimin e pagesave dhe të sigurojë se të gjitha faturat e vlefshme paguhen brenda afatit prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 3,114,538€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 409 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 241 me orar të plotë dhe 168 me orar jo të plotë.

Çështja B6 - Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore

Gjetja	Sipas nenit 35, pika 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik përcaktohet se “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë”. Gjatë auditimit është konstatuar se në katër (4) raste është tejkaluar afati ligjor për ushtrimin e pozitave me ushtrues detyre, ku kohëzgjatja e tejkalimit varion nga katër (4) muaj deri në njëzet (20) muaj. Këto raste janë evidentuar në sektorin e arsimit. Në pozitat e mbuluara me ushtrues detyre nuk janë ndërmarrë procedura për shpalljen e konkurseve. Zgjatja përtej afatit ligjor e ushtrimit të detyrës në pozita drejtuese ka ardhur si rezultat i mosndërmarrjes së masave të mjaftueshme nga menaxhmenti për adresimin e situatës dhe mungesës së angazhimit të duhur për mbulimin e këtyre pozitave.
Ndikimi	Mbajtja e pozitave drejtuese me ushtrues detyre përtej periudhës së përcaktuar me ligj përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe rrezikon që këto pozita të udhëhiqen nga persona që nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme për atë pozitë.
Rekomandimi B6	Kryetari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar rekrutimin e rregullt për pozitat që aktualisht mbulohen me ushtrues detyre, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 204,148,092€, pasurive jokapitale është 66,521€, si dhe e stoqeve 368€.

Çështja B7 - Mungesa e inventarizimit të pasurisë dhe mosfunksionalizimi i sistemit E-pasuria

Gjetja

Neni 19 paragrafi 4.3 i rregullores Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”. Ndërsa, sipas nenit 6, pika 3 të kësaj rregulloreje, pasuritë jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen dhe menaxhohen nga program e-pasuria.

Pasuritë jokapitale nën 1,000€ dhe stoqet në Komunën e Novobërdës përkundër rekomandimeve të dhëna ende nuk regjistrohen në sistemin e-pasuria, por ato regjistrohen në formatin Excel.

Komuna nuk ka realizuar inventarizimin e pasurisë për vitin 2025. Ky proces është zhvilluar vetëm në Drejtorinë e Administratës komunale, ndërsa ka munguar në sektorët si: arsimi, kultura, rinia, sporti, shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Kjo kishte ndodhur për shkak të përpjekjeve të pamjaftueshme nga Komuna për funksionalizimin e këtij sistemi. Ndërsa, mos kryerja e inventarizimit të pasurisë rezulton me mungesën e përgjegjësisë në kryerjen e detyrave të përcaktuara nga Zyrtaari kryesor administrativ.

Ndikimi

Mos funksionimi i sistemit e-pasuria pamundëson menaxhimin dhe kontrollin efektiv të pasurive jo kapitale, përderisa mbajtja e evidencave manuale për pasuritë rrezikon në mundësinë e gabimeve në këto regjistra. Mos kryerja e inventarizimit, rezulton me mangësi në informatat e plota lidhur me pasuritë.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të ndërmarrë masa konkrete për të siguruar funksionalizimin e plotë të sistemit e-Pasuria dhe përdorimin e tij nga të gjitha drejtoritë komunale për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive jokapitale dhe stoqeve. Po ashtu, duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të zhvillohet në të gjitha njësitë organizative, në mënyrë që gjendja reale e pasurisë të reflektohet me saktësi në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Novobërdës në PFV-të e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,389,464€. Kjo vlerë përbëhet prej tatimit në pronë në vlerë 1,293,363€, të hyrave nga qiraja prej 40,101€ dhe taksës për ushtrimin e veprimtarisë prej 56,000€. Gjatë vitit 2025, llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë janë rritur për 283,588€ ose 28% krahasuar me vitin 2024.

Çështja B8 - Mosndërmarrja e veprimeve për arkëtimin e borxheve

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme përcaktohet se Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore që kalojnë shumë 10€.

Në nenin 27 përcaktohet se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Gjatë vitit 2025, vlera totale e borxheve të arkëtueshme të Komunës ka arritur në 1,389,464€, nga të cilat 1,293,363€ (93%) lidhen me tatimin në pronë. Edhe pse komuna ka ndërmarrë veprime duke dërguar njoftime për borxhlinjtë me detyrime mbi 300€, nuk janë ndërmarrë masa të tjera konkrete ligjore për inkasimin e këtyre borxheve.

Mungesa e veprimeve konkrete ka rezultuar nga mosangazhimi i vazhdueshëm i njësive përgjegjëse për arkëtimin e të hyrave, si dhe mungesës së një plani të koordinuar për trajtimin e borxheve të pambledhura.

Ndikimi

Mosinkasimi i borxheve të akumuluar ndikon drejtpërdrejt në rënie të nivelit të të hyrave vetanake, duke kufizuar kapacitetin financiar të komunës për realizimin e objektivave të saj zhvillimore dhe projekte kapitale që varen nga fondet vetanake.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për menjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Komunë të Novobërdës operon me vetëm Drejtorin e NjAB-së. Për vitin 2025 kjo njësi kishte hartuar planin strategjik për periudhën 2025-2027.

Çështja B9 - Mungesa e Komitetit të auditimit dhe e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve

Gjetja

Sipas nenit 4 të Udhëzimit Administrativ MF Nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e sektorit publik, “çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në nivel të organit kryesor, është i obliguar të themelojë Komitetin e Auditimit.”

Po ashtu, neni 9 pika 7 i Rregullores QRK Nr. 01/2019 për funksionimin e auditimit të brendshëm përcakton se auditorët e brendshëm duhet të monitorojnë në mënyrë sistematike zbatimin e rekomandimeve, bazuar në një plan veprimi të miratuar nga udhëheqësi i institucionit

Komuna nuk e ka themeluar Komitetin e Auditimit, ndonëse kjo kërkohet me bazë ligjore.

Mangësitë e evidentuara janë rezultat i mungesës së përkushtimit nga ana e menaxhmentit komunal për të respektuar kërkesat ligjore që rregullojnë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Moskrijimi i Komitetit të Auditimit dhe mosndërmarrja e veprimeve për hartimin e planeve të veprimit pasqyrojnë një qasje të dobët institucionale ndaj rolit të auditimit të brendshëm dhe rekomandimeve të tij.

Ndikimi

Mungesa e një strukture funksionale për ndjekjen e rekomandimeve, si dhe mungesa e Komitetit të Auditimit, rrezikojnë integritetin dhe besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, e kufizojnë vlerësimin e masave korrigjuese të ndërmarra nga menaxhmenti dhe pamundësojnë marrjen e vendimeve të bazuara në informata për përmirësimin e proceseve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të ndërmarrë masa për themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit të Auditimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, duhet të sigurojë që të gjitha drejtoritë përkatëse të hartojnë dhe dorëzojnë plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,284,877	4,775,980	4,572,916	4,238,629	4,061,733
Grante Qeveritare - Buxheti	3,852,119	4,101,847	4,037,766	3,507,299	3,445,606
Të bartura nga viti i kaluar	0	214,749	182,789	290,249	266,477
Të hyrat vetanake	432,758	432,758	352,361	407,584	195,189
Donacionet vendore	0	23,572	0	33,496	0
Donacionet e jashtme	0	3,054	0	0	154,460

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për vlerën 491,103€ ose rreth 11%, që reflekton rritje të buxhetit gjatë vitit fiskal.

Në vitin 2025, janë shpenzuar 4,572,916€, që përfaqëson rreth 96% të buxhetit final, duke treguar një nivel shumë të mirë të realizimit të buxhetit.

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për vlerën 491,103€ ose rreth 11%, që reflekton rritje të buxhetit gjatë vitit fiskal.

Në vitin 2025, janë shpenzuar 4,572,916€, që përfaqëson rreth 96% të buxhetit final, duke treguar një nivel shumë të mirë të realizimit të buxhetit.

Burimi kryesor i financimit mbetet Grantet Qeveritare - Buxheti, ndërsa:

- Të barturat nga viti i kaluar në vlerë 214,749€ kanë kontribuar në financimin e aktiviteteve gjatë vitit;
- Të hyrat vetanake në vlerë 432,758€ përbëjnë një burim të rëndësishëm financiar; dhe
- Donacionet vendore dhe të jashtme janë në vlera relativisht të vogla dhe nuk kanë ndikim të madh në strukturën e përgjithshme të financimit.

Krahasuar me vitet paraprake, vërehet një trend rritës i shpenzimeve, që tregon zgjerim të aktiviteteve.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,284,877	4,775,980	4,572,916	4,238,629	4,061,733
Pagat dhe mëditjet	2,864,810	3,114,538	3,114,538	2,728,133	2,632,915
Mallrat dhe shërbimet	520,000	589,961	582,303	678,988	513,484
Komunalitë	120,000	130,000	129,996	110,006	91,508
Subvencionet dhe transferet	320,000	373,477	349,541	413,891	350,801
Investimet Kapitale	460,067	568,004	396,538	307,611	473,025

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike buxhetore janë dhënë si më poshtë:

- Buxheti final për pagat dhe mëditjet është më i lartë për 249,728€ krahasuar me buxhetin fillestar. Shpenzimet janë realizuar në 3,114,538€, që përfaqëson 100% të buxhetit final, duke reflektuar stabilitet dhe ekzekutim të plotë.
- Buxheti final për mallrat dhe shërbimet është më i lartë për 69,961€, ndërsa shpenzimet arritën në 582,303€, që përfaqëson rreth 99% të buxhetit final, duke treguar nivel shumë të lartë realizimi.
- Buxheti final për komunalitë është rritur për 10,000€, ndërsa shpenzimet janë realizuar në 129,996€, që përfaqëson pothuajse 100% të buxhetit final.
- Buxheti final për subvencionet dhe transferet është rritur për 53,477€, ndërsa shpenzimet janë realizuar në 349,541€, që përfaqëson rreth 94% të buxhetit final.
- Buxheti final për investimet kapitale është rritur për 107,937€, ndërsa shpenzimet arritën në 396,538€, që përfaqëson rreth 70% të buxhetit final, duke treguar nivel më të ulët të realizimit krahasuar me kategoritë tjera, që paraqet sfida në implementimin e projekteve kapitale.

Në përgjithësi, struktura e shpenzimeve dominohet nga pagat dhe mëditjet, ndërsa investimet kapitale mbeten sfidë për realizim të plotë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Komuna për vitin 2025 kë pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë 116,736€ të cilat alokohen për shpenzim në baza të rregullta tremujore. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme, pasi ato planifikohen dhe realizohen nga Ministria e Punëve të Brendshme po ashtu, nuk janë përfshirë as të hyrat nga gjobat e shqiptuara nga gjykatat, në vlerë prej 7,400€ dhe të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve në vlerë 15,424€.

Buxheti fillestar dhe ai final për të hyrat ishte 432,758€, ndërsa realizimi në vitin 2025 arriti në 461,833€, që paraqet një tejkalim prej 29,075€ ose rreth 7%. Realizimi i të hyrave lidhet me arkëtimin nga tatimi në pronë, taksa për lejet e ndërtimit, taksat rrugore, qiraja, tarifat për lëshimin e certifikatave, si dhe nga shërbime të ndryshme administrative, etj.

-Të hyrat tatimore janë realizuar në 277,725€, duke tejkaluar ndjeshëm planifikimin dhe duke përbërë pjesën kryesore të rritjes së të hyrave.

-Të hyrat jo tatimore janë realizuar në 184,108€, që është më e ulët se planifikimi, por me kontribut të rëndësishëm në total.

Krahasuar me vitet 2024 dhe 2023, të hyrat mbeten relativisht të qëndrueshme, me luhatje ndërmjet kategorive.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	432,758	432,758	461,833	496,983	430,478
Të hyrat tatimore	106,859	106,859	277,725	188,639	153,462
Të hyrat jo tatimore	325,899	325,899	184,108	308,344	277,016

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Komunës së Novobërdës ka rezultuar në pesëmbëdhjetë (15) rekomandime kryesore.

Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, katër (4) rekomandime ishin zbatuar dhe njëmbëdhjetë (11) rekomandime nuk kishte filluar zbatimin ende.

Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që të ndërmerren veprime për përmirësimin e menaxhimit të pasurisë, duke garantuar që regjistrimi dhe klasifikimi i të gjitha pasurive të bëhet në përputhje me gjendjen reale dhe kërkesat ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të sigurojë bashkëpunim më të mirë ndërmjet Zyrës Ligjore dhe Zyrës për Financa për të siguruar që të gjitha detyrimet kontingjente të raportohen me saktësi dhe të jenë të mbështetura me dokumentacionin përkatës. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime për të siguruar trashëgiminë e plotë të lëndëve juridike gjatë ndërrimit të stafit përgjegjës.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të siguruar që në të drejtoritë komunale të mbahen evidenca të vijueshmërisë në punë, në përputhje me kërkesat e rregullores në fuqi. Po ashtu, duhet të forcohet kontrolli dhe përgjegjësia menaxheriale për zbatimin e kësaj kërkesë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm mbi ekzekutimin e pagesave dhe të sigurojë se të gjitha faturat e vlefshme paguhen brenda afatit prej 30 ditësh.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimi i fondeve publike të bëhet në përputhje të plotë me legjislacionin e aplikueshëm për menaxhimin e financave publike. Çdo kontraktim i punëve apo shërbimeve duhet të realizohet përmes procedurave të rregullta të prokurimit, ndërsa çdo pagesë duhet të mbështetet në një raport të pranimit të mallrave apo shërbimeve.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Baza për konkluzion	Komuna duhet të sigurojë që të gjitha marrëveshjet për angazhimin e punëtorëve të përmbajnë specifikime të qarta për nivelin e kompensimit për secilën pozitë. Për më tepër, mënyra e llogaritjes së pagesave duhet të jetë e dokumentuar dhe transparente, në mënyrë që të garantohet menaxhim i drejtë i mjeteve publike.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar

9.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontratat e punës për zyrtarët komunal të azhurnohen dhe janë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Zyrtarët Publik.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
10.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar rekrutimin e rregullt për pozitat që aktualisht mbulohen me ushtrues detyre, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar që çdo mbështetje financiare për OJQ-të në të ardhmen të bëhet vetëm pas publikimit të thirrjeve publike, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme për të parandaluar dhënien e subvencioneve pa procedurë, të kërkohej dokumentacion i plotë dhe zyrtar në rastet e ndarjes ose transformimit të OJQ-ve, dhe të sigurohet që përzgjedhja e përfituesve të bazohet në parime të transparencës, konkurrencës dhe llogaridhënies.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
12.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve të bëhet vetëm mbi bazën e përmbushjes së plotë të kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike, duke përfshirë verifikimin e saktë dhe në kohë të dokumentacionit të kërkuar.	Janë ndërmarrë veprimet.	I zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të ndërmarrë masa konkrete për të siguruar funksionalizimin e plotë të sistemit e-Pasuria dhe përdorimin e tij nga të gjitha drejtoritë komunale për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive jokapitale dhe stoqeve. Po ashtu, duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të zhvillohet në të gjitha njësitë organizative, në mënyrë që gjendja reale e pasurisë të reflektohet me saktësi në pasqyrat financiare vjetore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi
15.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit të Auditimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, duhet të sigurojë që të gjitha drejtoritë përkatëse të hartojnë dhe dorëzojnë plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së.	Nuk janë ndërmarrë veprimet.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike	Ne konsiderojmë se në rastin e ekzekutimit të pagesave nga thesari për obligimet e kontratës kolektive, ne nuk jemi përgjegjës për ato pagesa, sepse pagesat ekzekutohen nga thesari, ku deri vitin e kaluar ishte praktikë që ato ekzekutime të paguheshin nga kodi Paga dhe mëditje, pasi obligimet potenciale kanë lindur nga kontrata kolektive për atë kategori ekonomike.	Çështjen B3 - Edhe pse Komuna ka arsyetuar çështjen, kjo mbetet të përmissohet në të ardhmen.

Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë	Komuna pranon rëndësinë e mbajtjes së evidencës së prezencës së punonjësve në përputhje me nenin 17 të Rregullores (QRK) nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe prezencën e zyrtarëve publikë, dhe në vazhdimësi ndërmerr masa për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret në fuqi. (p. 1) Megjithatë, është e nevojshme të theksohet se gjatë periudhës raportuese, në disa njësi organizative janë shënuar probleme teknike në funksionimin e sistemit elektronik për evidencën e prezencës. (p. 1) Këto probleme kishin të bënin me ndërprerje të kohëpaskohshme në punën e pajisjeve për regjistrim, (p. 1) instabilitet të infrastrukturës së rrjetit, si dhe disa vështirësi teknike gjatë transferimit dhe regjistrimit të të dhënave në sistem. (p. 2) Për shkak të rrethanave të lartpërmendura, në disa raste nuk ka qenë e mundur të sigurohet regjistrimi elektronik i vazhdueshëm i prezencës së të gjithë zyrtarëve. (p. 2) Kjo situatë nuk ka qenë pasojë e mosrespektimit të qëllimshëm të obligimeve ligjore, por e kufizimeve teknike objektive që kanë ndikuar përkohësisht në funksionimin e sistemit. (p. 2) Komuna ka ndërmarrë aktivitete për eliminimin e mangësive të vërejtura përmes mirëmbajtjes dhe avancimit të pajisjeve ekzistuese, si dhe përmes koordinimit me shërbimet kompetente për të siguruar një punë më të besueshme të sistemit. (p. 2) Njëkohësisht, udhëheqësit e njësive organizative janë udhëzuar që, në rastet kur evidenca elektronike nuk është e qasshme për arsye teknike, të përdorin mënyra alternative të regjistrimit të prezencës në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së përmendur.	Çështjen B4 - Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë, mbetet pasi Komuna ka arsyetuar çështjen.
---	--	--

Vonesat në pagesën e faturave	Konsiderojmë se vonesat në pagesën e faturave kanë ndodhur për shkak të ekzekutimeve nga thesari, ku mjetet tona të parapara për obligime nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime na janë marrë për nevojat e ekzekutimeve nga përmbaruesit privatë për kontratën kolektive, prandaj nuk kemi qenë në gjendje të bëjmë pagesën e obligimeve tona të dospishme (të arritura) nga kategoria Mallra dhe Shërbime	Çështja B5 - Vonesat në pagesën e faturave, kjo çështje mbetet të përmissohet në të ardhmen.
-------------------------------	---	--

Mbajtja e pozitive me ushtrues detyre përtej afateve ligjore	Dëshiroj t'ju njoftoj lidhur me kontratat e drejtorëve të shkollave si ushtrues detyre të drejtorëve. Drejtorja për Arsim dhe Kulturë, pas skadimit të kontratave të rregullta të drejtorëve të shkollave, menjëherë ka dorëzuar propozimin të kryetari i komunës për emërimin e drejtorëve të rinj si ushtrues detyre të drejtorit, ku kryetari, me vendim në përputhje me ligjin, ka emëruar të njëjtit sipas propozimit tonë. Në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës SHFMU (Shkolla Filllore e Mesme e Ulët në Minatorë) kemi shpallur konkursin, ku e kemi shpallur dy herë, për shkak të mungesës së kandidatëve të kualifikuar për drejtorë shkollash, prandaj edhe më tutje kemi ushtrues detyre të drejtorëve. Në shkollat serbe kemi më shumë ushtrues detyre të drejtorëve sepse, siç e thashë më lart, kontratat e ish-drejtorëve kanë skaduar. (p. 2) Ne si drejtorë jemi përpjekur me organizata të ndryshme të gjejmë modalitete se si t'i trajnojmë mësimdhënësit për trajnimin për drejtor shkolle, që është kusht për aplikim për drejtor shkolle, gjithashtu kemi probleme që mësimdhënësit nuk janë në gjendje të pajisen me licencë për mësimdhënie, gjë që është po ashtu kriter për aplikim për drejtor shkolle. Prandaj, për shkak të këtyre problemeve, i kemi këta drejtorë si ushtrues detyre të drejtorëve. Ne si drejtor për arsim dhe kulturë kemi në planin tonë të personelit për vitin 2026 shpalljen e të gjitha vendeve të lira për drejtorë shkollash, prandaj këto vende të lira do të shpallen, ashtu siç jemi të obliguar me ligj, por kemi sfidën që nuk kemi kandidatë të kualifikuar, veçanërisht në shkollat serbe për arsyet e lartpërmendura.	Çështja B6 - Komuna ka arsyetuar, kjo çështje mbetet të përmisohet në të ardhmen.
---	---	--

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së
lidhur me raportin e auditimit



Opština Novo Brdo
Komuna e Novobërdës
Municipality of Novo Brdo



PISMO POTVRDE

O uskladenosti sa nalazima Generalnog revizora za 2025. godinu i sprovođenju
preporuka

Za: Nacionalnu kancelariju za reviziju

Poštovani,

Ovim putem potvrđujem da:

- primio sam nacrt izveštaja Nacionalne kancelarije za reviziju o reviziji Finansijskih izveštaja Opštine Novo Brdo za 2025. godinu ;
- delimično saglasan sam sa nalazima i preporukama i nemam nikakvih komentara na sadržaj Izveštaja, smatramo da postoje razumna objasnjenja sa nase strane za neke nalaze, kao recimo za nalaze:

Pitanje B3: Pogresna klasifikacija troskova u ekonomske kategorije. Mi smatramo da u slucaju izvršenja placanja iz trezora za obaveze kolektivnog ugovora mi nismo odgovorni za ta placanja, jer se placanja izvršavaju iz trezora, gde je do prosle godine bila praksa da se ta izvršenja isplacuju iz kod Plata I dnevnice jer su potencijalne obaveze nastale iz kolektivnog ugovora za tu ekonomsku kategoriju.

Pitanje B4: Nedostatak dokaza o dolasku/odlasku na posao. Opština prihvata značaj vođenja evidencije prisustva zaposlenih u skladu sa članom 17 Uredbe (QRK) br. 04/2024 o radnom vremenu, praznicima i prisustvu javnih funkcionera i kontinuirano preduzima mere za obezbeđivanje uskladenosti sa važećim propisima.

Medutim, potrebno je istaci da su tokom izveštajnog perioda u pojedinim organizacionim jedinicama zabeleženi tehnički problemi u funkcionisanju elektronskog sistema za evidenciju prisustva. Ovi problemi su se odnosili na povremene prekide u radu uređaja za registraciju,

nestabilnost mrežne infrastrukture, kao i određene tehničke poteškoće prilikom prenosa i evidentiranja podataka u sistemu.

Usled navedenih okolnosti, u pojedinim slučajevima nije bilo moguće obezbediti kontinuiranu elektronsku registraciju prisustva svih službenika. Ovakva situacija nije bila posledica namernog nepoštovanja zakonskih obaveza, već objektivnih tehničkih ograničenja koja su privremeno uticala na funkcionisanje sistema.

Opština je preduzela aktivnosti na otklanjanju uočenih nedostataka kroz održavanje i unapređenje postojeće opreme, kao i kroz koordinaciju sa nadležnim službama radi obezbeđivanja pouzdanijeg rada sistema. Istovremeno, rukovodioci organizacionih jedinica su upućeni da, u slučajevima kada elektronska evidencija nije dostupna iz tehničkih razloga, koriste alternativne načine evidentiranja prisustva u skladu sa članom 17 stav 3 navedene Uredbe.

Pitanje B5- Zakasnjnje na isplate obaveza – racuna, smatramo da kasnjenja u placanju faktura nastala su zbog izvršenja trezora, gde su nam sredstva predviđena za obaveza iz ekonomske kategorije Robe I usluge oduzimana za potrebe izvršenja privatnih izvršitelja iz kolektivnog ugovora, zato nismo bili u mogućnosti da vrsimo isplatu naših dospelih obaveza iz kategorije Robe I usluga,

Pitanje B6: Obavljanje vršilaca dužnosti nakon zakonskih rokova

Želeo sam da vas obavestim o ugovorima direktora škola kao vršilaca dužnosti direktora.

Direktorat za obrazovanje i kulturu, nakon isteka redovnih ugovora direktora škola, odmah je podneo predlog gradonačelniku opštine za imenovanje novih direktora za vršiće dužnosti direktora, gde je gradonačelnik, odlukom u skladu sa zakonom, imenovao iste na naš predlog.

U Ministarstvu za obrazovanje i kulturu SHFMU (Školski univerzitet u Minatoriju) objavili smo konkurs, gde smo ga objavili dva puta, zbog nedostatka kvalifikovanih kandidata za direktore škola, stoga i dalje imamo vršiće dužnosti direktora.

U srpskim školama imamo više vršilaca dužnosti direktora jer, kao što sam rekao gore, ugovori bivših direktora su istekli. Mi kao direktori smo pokušali sa raznim organizacijama da pronademo modalitete kako da obučimo nastavnike za obuku za direktora škole, što je uslov za prijavu za direktora škole, takođe imamo probleme da nastavnici nisu u mogućnosti da dobiju licencu za nastavu, što je takođe kriterijum za prijavu za direktora škole.

Stoga, zbog ovih problema, imamo ove direktore za vršiće dužnosti direktora.

Mi kao direktor za obrazovanje i kulturu imamo u našem kadrovskom planu za 2026. godinu objavu svih upražnjenih mesta za direktore škola, stoga će ova upražnjena mesta biti objavljena,

kako smo obavezni po zakonu, ali imamo izazov da nemamo kvalifikovane kandidate, posebno u srpskim školama iz gore navedenih razloga.

- u roku od 30 dana od prijema konačnog Izveštaja dostaviću vam Akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će obuhvatiti vremenske rokove i osoblje odgovorno za njihovo sprovođenje.

G. Sasa Milosevic

Funkcija: Gradonačelnik Opštine Novo Brdo

Datum: 12.06.2026. godine

Potpis: 



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.